

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6828  
E premte, 17 shkurt 2023  
çmimi 0.40 €

Presidenti Begaj: Shqipëria do të jetë vazhdimisht në krah të Kosovës | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", ADEM GRABOVCI | FAQE 7

## 17 SHKURTI, KURORËZIM I PËRPPJEKJEVE NDËR BREZA PËR LIRI DHE PAVARËSI

- Festa e 15-vjetorit të pavarësisë është e zbehtë pa liderët e UÇK-së dhe protagonistët kryesorë të 17 shkurtit

Një ndër nënshkruesit e Deklaratës së Pavarësisë, Adem Grabovci, ka thënë se 17 shkurti i vitit 2008 është kurorëzim i përpjekjeve ndër breza të popullit të Kosovës për liri dhe pavarësi. Grabovci në këtë intervistë për "Epokën e re" ka thënë se për 15 vjet shtet Kosova ka arritur shumë. Grabovci ka bërë me dije se festa e pavarësisë është e zbehtë pa liderët e UÇK-së të cilët gjenden në Hagë. "Personalisht jam i thyer shpirtërisht për mungesën e tyre fizike në këtë përvjetor për shkak se me ta kam rrugëtuar në angazhimin tonë të përbashkët për liri dhe pavarësi. Për mua ata janë ndër figurat më meritore të luftës dhe pavarësisë", ka thënë Grabovci



LËVIZJA VETËVENDOSJE E SHKARKON NGA POZITA E KRYETARIT TË KOMISIONIT PËR PUNË TË JASHTME NË KUVENDIN E KOSOVËS, DEPUTETIN HAKI ABAZI

## HAKI ABAZI I AKUZON KURTIN DHE HAXHIUN PËR ZHDUKJEN E MOSTRAVE TË ASTRIT DEHARIT



- Abazi: Si është e mundur që në pushtetin e LV-së të zhduken mostrat e Astrit Deharit

### AKTUALE



KURTI: ME PLANIN FRANKO-GJERMAN KA NJOHJE DE FAKTO NGA SERBIA, NJOHJA DE JURE DO TË ARRIHET NDËRKOHË F. 5

NATO-ja DO TË DËRGOJË "DHJETËRA MIJËRA" TENDA NË TURQI F. 2

SHBA-ja: NUK KA NDRYSHUAR POZICIONI PËR NJOHJEN RECIPROKE NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË F. 2

KURTI PRITI NË TAKIM NJERIUN QË I PRIU EKIPIT LIGJOR TË KOSOVËS NË GJND F. 3

### EKONOMI



A OFRON "SUPERPUNA" PUNËSIM TË QËNDRUESHËM? F. 8

### SPORT



PENSIONOHET KATËR HERË FUTBOLLISTI MË I MIRË NË KOSOVË, MENTOR ZHDRELLA F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
+389 44 487 200  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Mob: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji biznesi.com](http://www.kolegji biznesi.com)  
info@kolegji biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## NATO-ja do të dërgojë "dhjetëra mijëra" tenda në Turqi

**BRUKSEL, 16 SHKURT** - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka thënë se aleanca veriatlantike planifikon të sigurojë strehim për mijëra persona që kanë mbetur në rrugë në Turqi si pasojë e tërmeteve vdekjeprurëse të 6 shkurtit. Nga tërmetet mbi 7 shkallë të Rihterit, që kanë goditur Turqinë dhe Sirinë, kanë

vdekur mbi 39 000 persona. Stoltenbergu ka thënë se NATO-ja është duke ndërtuar streha të përkohshme dhe planifikon të dërgojë "dhjetëra mijëra tenda" në Turqi në ditët dhe javët në vijim. Ai i ka bërë këto deklarata në një konferencë për medie me ministrin e Jashtëm turk Mevlut Cavusoglu në Ankara. "Kjo është katastrofa natyrore

më vdekjeprurëse në territorin e aleancës prej kur është themeluar NATO-ja", ka thënë Stoltenbergu, duke shtuar se NATO-ja do t'i përdorë "kapacitetet e saj strategjike" për të dërguar ndihmë. Vetëm në Turqi më shumë se 50 000 ndërtesa janë shkatërruar apo dëmtuar rëndë si pasojë e dridhjeve të tokës.



## Rreth 1.1 milion ukrainas shkuan në Gjermani më 2022

**BERLIN, 16 SHKURT** - Rreth 1.1 milion njerëz kanë shkuar nga Ukraina në Gjermani më 2022, duke e tejkuluar fluksin e migrantëve nga Lindja e Mesme më 2015, sipas të dhënave të Zyrës Federale të Statistikave të Gjermanisë. Dy të tretat e migrantëve nga Ukraina kanë shkuar në Gjermani në tre muajt e parë pas nisjes së luftës së Rusisë në Ukrainë, përkatesisht në periudhën mars-maj të vitit të kaluar. Të dhënat janë publikuar pak para se lufta e Rusisë në Ukrainë, e nisur më 24 shkurt, të mbushë një vit. Duke përjashtuar personat që janë kthyer sërish në Ukrainë, numri i migrantëve ukrainas në Gjermani ka shkuar në 962 000 më 2022, më

shumë se 834 000 persona që kanë shkuar nga Siria, Afganistani dhe Iraku në Gjermani në periudhën 2014-2016, është thënë në raportin më të ri. Këto shifra i kanë kthyer shtetasit ukrainas në popullatën e dytë më të madhe të migrantëve në Gjermani, pas turqve. Presidenti rus Vladimir Putin e quan luftën si "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën. Perëndimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.



## Opozita në Shqipëri proteston brenda dhe jashtë Kuvendit



**TIRANË, 16 SHKURT** - Me thujtë të njëjtin skenar si të tri ditëve më parë, opozita në Shqipëri protestoi para Kuvendit, por edhe brenda në seancën plenare. Mbështetës të opozitës u mblodhën para Kuvendit, ndërsa deputetë të opozitës u përplasën me punonjës të Gardës së Republikës që nuk lejuan deputetët e Partisë Demokratike, të përjashtuar nga seanca, të hynin në ambientet e Kuvendit. Listës prej tetë deputetësh të përjashtuar më herët iu shtuan edhe tre demokratë të tjerë, mes tyre kreu i kësaj partie, Sali Berisha, dhe deputetët Belind Këlliçi dhe Edi Paloka.

Në sallën e Kuvendit, deputetët e opozitës bllokuan sërish foltoren, në shenjë proteste për 12 deputetët e përjashtuar, si dhe për mungesën e kryeministrit Edi Rama. Në seancë mungoi edhe kryetarja e Kuvendit, Lindita Nikolla, shkarkimin e së cilës e kërkon opozita me pretendimin se nuk po zbaton rregulloren, referuar masave të ndërmarra për përjashtimin e disa deputetëve demokratë nga seancat plenare. Mes bllokimit të foltores herë pas here, si dhe zhurmës së bilbilave, në seancë u debatua për rastin "McConigal". Ministrija e Shtetit për Marrëdhënie me Parlamentin, Elisa Spiropali, tha

se e gjithë kjo zhurmë që bën opozita në Kuvend është frika e Berishës nga hetimet për 21 janarin. Replika e kreut të PD-së, Sali Berisha, erdhi nga ambientet jashtë Kuvendit, duke iu bashkuar protestuesve, pasi Kuvendi mori vendimin që mocioni për debat me kryeministrin shqiptar, Edi Rama, të mbahet më 2 mars. Protesta para Kuvendit zgjati rreth dy orë e 30 minuta. Edhe kësaj here protestuesit hodhën flakadanë dhe kapsolla, por nuk pati përplasje me forcat e policisë. Rreth 1 000 efektivë ishin të pranishëm për ta mbikëqyrur protestën e opozitës.

## Berlinalja hap dyert në kryeqytetin gjerman

**BERLIN, 16 SHKURT** - Edicioni i 73-të i Festivalit Ndërkombëtar të Filmit në Berlin nis të enjten duke iu kthyer formatit të rregullt, pas kufizimeve të shkaktuara në dy vjetet e fundit nga pandemia e koronavirusit. Këtë edicion pritet të shfaqen rreth 400 filma si dhe do të ketë diskutime që këtë herë kanë në fokus ofrimin e mbështetjes

për popullin e Ukrainës dhe Iranit. Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky pritet të mbajë një fjalim në hapje të festivalit përmes videolidhjes. Aktorja amerikane Kristen Stewart, e njohur për rolet e saj në filmat "Spencer" dhe "Twilight", është në krye të jurisë ndërkombëtare këtë vit.

Edicionin e këtij viti do ta hapë komedia "She Came to Me" e regjisores Rebecca Miller. Në total, 19 filma janë duke garuar për çmimet kryesore, prej të cilëve gjashtë janë krijuar nën regji të grave. Bashkë me festivalin e Kanës dhe atë të Venecias, Berlinalja është një prej festivaleve më të mëdha në botë.



# Presidenti Begaj: Shqipëria do të jetë vazhdimisht në krah të Kosovës

Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, me rastin e kremtimit të 15-vjetorit të pavarësisë, po qëndron për vizitë në Kosovë. Ai të enjten u prit nga presidentja Vjosa Osmani. Marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, nga të dy presidentët, u vlerësuan jo vetëm miqësore, por vëllazërore, ndaj u zotuan se do të angazhohen për bashkëpunim më të madh

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 16 shkurt - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të enjten në takim presidentin e Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj, i cili po qëndron në Kosovë për

të marrë pjesë në kremtimin e 15-vjetorit të pavarësisë së Kosovës.

Presidenti Begaj e ka uruar presidenten Osmani dhe qytetarët e Kosovës për 15-vjetorin e pavarësisë dhe ka theksuar se Shqipëria do të jetë vazhdimisht në krah të Kosovës



duke kontribuar në fuqizimin e pozitës ndërkombëtare të saj. Ndërkaq Osmani ka theksuar se Kosova po e kremton 15-vjetorin e shtetësisë së saj në përballje me sfida, por e vendosur për të ecur përpara në forcimin e shtetit dhe e përkushtuar në rrugëtimin euroatlantik. "Në këtë 15-vjetor të pavarësisë kujtojmë me respekt të gjithë ata që kontribuuan për lirinë, pavarësinë dhe shtetndërtimin, që nga arkitekti i shtetit të Kosovës, presidenti historik dr.

Ibrahim Rugova e deri te vajzat e djemtë e UÇK-së, të udhëhequr nga komandanti legjendar Adem Jashari, shumë nga të cilët ranë heroikisht për lirinë dhe Republikën", ka theksuar presidentja Osmani. Marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë nga të dy presidentët u vlerësuan jo vetëm miqësore, por vëllazërore, ndaj u zotuan se do të angazhohen për bashkëpunim më të madh. Në këtë funksion presidentja Osmani vuri në dukje nevojën

për harmonizim të mëtejshëm, posaçërisht në sferën e politikës së jashtme, me ç'rast potencoi nevojën që Shqipëria të jetë zë i fuqishëm i Kosovës në institucionet ku aktualisht Kosova nuk ka përfaqësim. Të dy presidentët theksuan se Kosova dhe Shqipëria janë bashkërisht të angazhuara dhe të përkushtuara në mbrojtjen e demokracisë, paqes dhe lirisë dhe se stabiliteti i rajonit është jetik në mënyrë që të dy shtetet ta vazhdojnë rrugëtimin evropian.

## Kurti priti në takim njeriun që i priu ekipit ligjor të Kosovës në GjND



PRISHTINË, 16 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka pritur të enjten në takim Michael Wood, nga Mbretëria e Bashkuar, i cili i ka prirë ekipit ligjor të Kosovës para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në vitin 2010. Kryeministri Kurti e falënderoi Woodin për kontributin e tij, veçanërisht për mbrojtjen ligjore të së drejtës ndërkombëtare të Kosovës me rastin e shpalljes së pavarësisë. Opinioni këshillëdhënës i GjND-së i vitit 2010, që konkludon se pavarësia e

Kosovës nuk kishte shkelur të drejtën ndërkombëtare, përbën një nga datat themelore të historisë së shtetit të Kosovës, andaj kryeministri Kurti tha se është kënaqësi të mirëpres e të takohet me Woodin pikërisht në vigjilje të 15-vjetorit të shpalljes së pavarësisë. Gjatë takimit kryeministri Kurti e njoftoi për të arriturat në vend, për zhvillimet aktuale, për reformat e ndërmarra në funksion të zhvillimit ekonomik, luftën kundër krimit dhe

korupsionit si dhe për forcimin e demokracisë. Ai diskutoi me Woodin edhe për marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe procesin e dialogut, për të cilin kryeministri tha se Republika e Kosovës në vazhdimësi ka qenë konstruktive dhe kreative në shërbim të normalizimit të plotë të marrëdhënieve me njohje reciproke në qendër. Në këtë takim Wood shoqërohej nga rektori i Universitetit të Prishtinës, Qerim Qerimi.

## Vitia nderoi veprën e profesionistëve shëndetësorë para obeliskut në QKUK

PRISHTINË, 16 SHKURT - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka nderuar veprën e profesionistëve shëndetësorë para obeliskut në përkujtim të sakrificës dhe kontributit të tyre ndër dekada. Ministri Vitia ka theksuar se pandemia Covid-19 ishte veç një prej sakrificave të stafit shëndetësor për të shpëtuar jetë që rrezikoheshin nga një

armik i padukshëm. "Por, me të njëjtin zell dhe përkushtim deri në vetëmohim, ata vepruan ndër dekada, pavarësisht prej represionit të dikurshëm që përfshinë periudha tragjike për vendin tonë. Puna dhe shëmbëlltyra e tyre është inspirim për brezat e rinj në rrugën që duhet të ndjekim në të ardhmen. Profesionistët

shëndetësorë ndër vite vendosën bazat dhe themelet jo vetëm të sistemit të shëndetësisë, por edhe të atdhedashurisë", ka thënë Vitia. Në këtë ngjarje ministri Vitia ka deklaruar se mbetet obligim yni moral dhe profesional që me punë ta dëshmojmë respektin ndaj tyre.



# Kurti: Me planin franko-gjerman ka njohje de fakto nga Serbia, njohja de jure do të arrihet ndërkohë

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 16 SHKURT - Kryeministri Albin Kurti u është përgjigjur pyetjeve të deputetëve gjatë seancës së Kuvendit të Kosovës. Duke folur për planin franko-gjerman ai ka thënë se aty parashihet njohja de fakto. “Ky propozim parasheh normalizim të marrëdhënieve ndërkombëtare ku Republika e Kosovës dhe ajo e Serbisë njohin njëra-tjetrën në formën de fakto. Një gjë e tillë duket e qartë në tekstin e marrëveshjes, por një gjë e tillë është premtuar edhe nga shtetet e emisarëve që e kanë propozuar marrëveshjen si dhe vetë Bashkimi Evropian”, tha ai. Kurti thotë se marrëveshja i vendos Kosovën dhe Serbinë si

dy identitete të barabarta. “Serbia nuk do të mund ta kundërshtojë anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare”.

I pari i qeverisë thotë se të gjitha këto janë parime fundamentale që shtetet e pavarura ua njohin njëra-tjetrës. Ai thotë se procesi i dialogut është në drejtimin e duhur për dallim nga e kaluara. “Njohje de jure e Serbisë nuk është në mënyrë eksplicite e shkruar në marrëveshje, por është pjesë sekuenciale e planit që do të arrihet në ndërkohë”, ka deklaruar Kurti.

Kryeministri thotë se Serbia nuk do të mund të anëtarësohet në bashkimin Evropian pa njohur Kosovën e që, sipas tij, një gjë e tillë nuk ka qenë kusht më parë. Kurti ka

thënë se deri më tani nuk kanë pranuar asnjë vendim në lidhje me njohje nga ndonjë shtet që kishte njohur Kosovën më parë. Kurti këtë e tha derisa iu përgjigj deputetes së PDK-së, Ariana Musliu-Shoshi, e cila pyeti nëse Republika e Togos ka tërhequr njohjes sipas deklaratave të ministrit të Jashtëm të Togos. “Republika e Togos ka deklaruar njohjen më 2 korrik 2014 dhe vendosja e marrëdhënieve diplomatike është bërë po atë vit, më 22 korrik. Nuk kemi pranuar një dokument ose vendim për shkëputje të marrëdhënieve diplomatike. Fushatat e Serbisë në këtë drejtim nuk janë ndalur asnjëherë. Qeveria nuk ka pranuar asnjë vendim për të ashtuquajturat tërheqje të njohjeve në asnjë prej rasteve

të përmendura nga Daçiqi dhe Vuçiqi”, ka thënë Kurti në Kuvend.

Kurti ka folur rreth largimit të qytetarëve të Kosovës. Ai ka thënë se shoqëria jonë duhet jetë e vëmendshme ndaj këtij fenomeni. “Sado që të jetë numri i lëvizjes së qytetarëve, vëmendja jonë si shoqëri duhet të jetë e shtuar, veçanërisht ajo institucionale, kur largimi i qytetarëve shtohet, sidomos i të rinjve”, ka thënë Kurti, për të vazhduar se qeveria e tij është duke punuar në vazhdimësi për secilin qytetar të vendit pa dallim.

Ai ka theksuar se synimi i qeverisë është ta kthejë besimin e qytetarëve ndaj institucioneve dhe shtetit, mirëqenien e tyre dhe “ta zvogëlojmë maksimalisht

migrimin”. “Fokusi ynë në zgjedhjet e 14 shkurtit, që pardje u bënë dy vjet, kanë qenë drejtësia dhe punësimi. Për të parën të gjithë pajtohen se policia ka bërë një punë të jashtëzakonshme në luftimin e krimit të organizuar. Nga fillimi i mandatit janë kryer 850 operacione policore, mbi 3 200 persona të arrestuar, 69 grupe kriminale janë shkatërruar, mbi 1.8 ton substanca narkotike janë sekuestruar, mbi 14 milionë euro janë ngrirë në dyshimin e keqpërdorimit ose shpëlarjes së parave. Duhet shumë angazhim dhe vullnet i hekurt nga sistemi i drejtësisë që proceset gjyqësore të shkojnë deri në fund për të marrë vendime meritore për kriminelët dhe keqpërdoruesit”, ka deklaruar Kurti.



Mostrat e Deharit u zhdukën në fillim të dhjetorit të vitit të kaluar.

Nga puna u pezulluan katër zyrtarë të Institutit të Mjekësisë Ligjore (IML).

Në lidhje me deklaratën e deputetit Abazi ka reaguar edhe avokati Tomë Gashi, i cili nga familja Dehari është i angazhuar për këtë rast. “Z. Haki Abazi dorëzoi provat në Prokurori. Pas prononcimeve të deputetit të Republikës së Kosovës, z. Haki Abazi, kam paraqitur kërkesë në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës për marrjen në pyetje të tij në

cilësinë e dëshmitarit. Z. Haki Abazi e ka borxh ndaj Astrit Deharit dhe e ka obligim ligjor që ta dëshmojë dhe t’i dorëzojë të gjitha provat që ai pretendon se i ka në Prokurori e që kanë të bëjnë me rastin e zhdukjes së mostrave biologjike dhe të gjakut të Astritit, të cilat janë zhdukur nga Instituti i Mjekësisë Ligjore në Prishtinë e që për zhdukjen e tyre është bërë e ditur para dy muajve”, ka shkruar Gashi në “Facebook”.

Gashi ka theksuar se deputeti Abazi ka deklaruar se ka bërë një hulumtim dhe se, sipas tij, ekzistojnë videoincizime me të cilat “dihet qartë se kush ka hyrë

te frigoriferi” në Institutin e Mjekësisë Ligjore. “Askush nuk mund të intervistohet para se të intervistohet z. Haki Abazi. Z. Abazi duhet të tregojë se pse ka heshtur deri më tani”, ka deklaruar avokati Gashi. Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka bërë me dije se ka dëgjuar me vëmendje deklaratat e deputetit të Kuvendit të Kosovës, Haki Abazi, dhënë për medie, dhe se shpejti do të ftohet për intervistim.

Deklarata e deputetit të LV-së, Haki Abazi, për zhdukjen e mostrave të Astrit Deharit dhe se për këtë çështje duhet të

merren në pyetje disa figura të Vetëvendosjes duke filluar nga kryeministri Kurti, ka ngjallur reagime të shumta.

Frashër Krasniqi nga PSD-ja, me anë të një shkrimi në “Facebook”, është shprehur se kjo qeveri nuk do të sjellë drejtësi, por edhe do ta sabotojë atë. “Ende pa ardhur Albin Kurti në pushtet kemi paralajmëruar që nuk do ta zbardhë rastin e Astritit. Kemi kërkuar drejtësi tash e dy vjet e asnjë gur s’është lëvizur prej kësaj qeverie për ta vënë drejtësinë në vend. Çdo ditë që po kalon, po dëshmohet pa dyshim, që le që këta nuk do të sjellin drejtësi, por edhe do ta

sabotojnë atë. Sepse nuk u konvenon. Astritin e patën për fushata elektorale. E kur ato u kryen, nuk u duhet më. Përveç përkujtimeve hipokrite te varri i tij”, ka shkruar Krasniqi.

Aktivisti i Lëvizjes Vetëvendosje, Astrit Dehari, u gjet i vdekur në qelinë e burgut në Prizren në nëntor të vitit 2016, ku po mbahej i paraburgosur nën dyshimin se kishte kryer sulm ndaj ndërtesës së Kuvendit bashkë me disa aktivistë të tjerë. Teksa Prokuroria atëkohë pati thënë se është vetëvrasje, familja në vazhdimësi ka insistuar se bëhet fjalë për vrasje.



LËVIZJA VETËVENDOSJE E SHKARKON NGA POZITA E KRYETARIT TË KOMISIONIT PËR PUNË TË JASHTME NË KUVENDIN E KOSOVËS, DEPUTETIN HAKI ABAZI

# Haki Abazi i akuzon Kurtin dhe Haxhiun për zhdukjen e mostrave të Astrit Deharit

- Abazi: Si është e mundur që në pushtetin e LV-së të zhduken mostrat e Astrit Deharit

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Haki Abazi, në një konferencë për medie mbajtur të enjten, ka thënë se kryeministri i vendit, Albini Kurti, ka urdhëruar shkarkimin e tij nga pozita e kryetarit të Komisionit për Punë të Jashtme në Kuvendin e Kosovës. Abazi ka përmendur disa videoincizime që kanë të bëjnë me LV-në, që tregojnë për ngulfatjen e zërit të deputetëve përbrenda Kuvendit dhe për mostrat e rastit të Astrit Deharit. Deputeti Abazi ka theksuar se si është e mundur që në pushtetin e Vetëvendosjes të zhduken mostrat e Astrit Deharit. Ai në lidhje me zhdukjen e mostrave të Astrit Deharit e ka akuzuar kryeministrin Kurti dhe ministren e Drejtësisë

hidhërohem shumë dhe do të bëhem pjesë e atyre që duan ta rrëzojnë nga qeveria. Dy vjet pas marrjes së mandatit Kurti është në kërkim të atyre që duan ta rrëzojnë nga qeveria”, ka deklaruar ai.

Deputeti Abazi ka përmendur disa videoincizime që kanë të bëjnë me LV-në që tregojnë për ngulfatjen e zërit të deputetëve përbrenda Kuvendit dhe për mostrat e rastit të Astrit Deharit. “Audio e videoincizimet tregojnë për ngulfatjen e zërit të deputetëve përbrenda parlamentit.

Këto audioincizime e videoincizime janë ato që ju duhet t’i kërkoni për të konfirmuar se kush i ka zhdukur mostrat e rastit Dehari. Hulumtimi im i fundit, pyetjet e mia që kam shtruar e diskutimet që kam bërë me njerëz përgjegjës, kanë sjellë shkarkimin përbrenda Vetëvendosjes. Shkarkimi im është minor kundrejt borxhit që kemi për të sqaruar deri në fund se çfarë ka ndodhur me rastin

Dehari dhe si është e mundur që në pushtetin e LV-së të zhduken mostrat e Astrit Deharit dhe kryeministri Kurti të mos e thotë asnjë fjalë të vetme për këtë gjë. Asnjë. Por ne as si shoqëri as si qytetarë individualë e as si deputetë s’mund të rrimë të heshtur përballë një procesi të këtillë dhe duhet ta kryejmë punën. Instituti i Mjekësisë Ligjore është i monitoruar 24 orë prej kamerave. Dihet qartë se kush ka hyrë te frigoriferi dhe ka nxjerrë mostrat që kanë qenë të vendosura nën mostrat e tjera e janë zhdukur”, ka thënë Abazi. Po ashtu, deputeti Abazi ka theksuar se rrjedhimisht porosia e tij për Albulena Haxhiun është që ta kryejë punën e saj si ministre që ka obligim para qytetarëve dhe deputetëve. “Ajo dje deklaroi se grupi parlamentar ka vendosur të bëhet shkarkimi im. Kjo është një gënjeshtër e pastër, sepse s’ka vendim nga grupi parlamentar i LV-së për shkarkim. Pra, s’ka votim e

vendim. Rrjedhimisht, ajo lëshon një të pavërtetë. Zonja Haxhiu duhet të jetë e përgjegjshme dhe me përgjegjësi për atë çfarë ka ndodhur në ministrinë që ajo drejton”, ka deklaruar deputeti Haki Abazi pak orë para shkarkimit.

Për akuzat e Abazit ka folur Avni Dehari, babai i Astrit Deharit. Dehari ka thënë se nëse Abazi e ka ditur këtë më herët, pse ka heshtur deri më sot. “Rasti i mostrave ka ndodhur më 08.12.2022. Pyetini ata që tash ngritën pse kanë heshtur atëherë dhe pse duan të flasin tani për këtë rast”, ka thënë ai për “Front Online”.

Ai thotë se arsyet që po flitet tani për mostrat e zhdukura të Astritit janë vetëm synimet personale. “Nuk dua të lëshohem në rrafshin e atyre personave që rastin e Astritit dhe çdo rast tjetër e shfrytëzojnë për realizimin e synimeve personale”, u shpreh Avni Dehari.

## ShBA-ja: Nuk ka ndryshuar pozicioni për njohjen reciproke në mes të Kosovës dhe Serbisë

PRISHTINË, 16 SHKURT - Një zëdhënës i Departamentit amerikan të Shtetit i ka thënë të enjten "Radio Evropa e Lirë" se Shtetet e Bashkuara nuk e kanë ndryshuar pozicionin sa i përket njohjes reciproke në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Në përgjigje është thënë se "Shtetet e Bashkuara e mbështetin plotësisht dialogun e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian në mes të Kosovës dhe Serbisë përmes të cilit synohet të arrihet një marrëveshje gjithëpërfshirëse me qëllim përfundimtar njohjen reciproke".

Çështja e njohjes është aktualizuar pas letrave të dërguara nga presidenti amerikan Joe Biden dhe sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, te presidenti serb Aleksandër Vuçiq, për ditën e shtetësisë së Serbisë, më 15 shkurt, në të cilat nuk është

përmendur në mënyrë specifike njohja reciproke mes dy vendeve.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë të mërkurën se në marrëveshjen përfundimtare me Serbinë duhet të përfshihet njohja. Ai i ka bërë këto deklarata teksa e ka komentuar propozimin e Bashkimit Evropian për normalizimin e marrëdhënieve mes dy vendeve.

Planin e kanë pranuar si Kosova ashtu edhe Serbia, por ai nuk është paraqitur asnjëherë në publik. Në një draft që e ka parë "Radio Evropa e Lirë", aty nuk përmendet në mënyrë specifike njohja, por parashihen të drejta të barabarta për Kosovën dhe Serbinë, respektim i integritetit territorial, paprekshmëri e kufijve, njohje e simboleve shtetërore dhe një aranzhim i veçantë për komunitetin serb në Kosovë.



Kosova dhe Serbia i kanë nisur negociatat e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian më 2011. Përgjatë kësaj kohe janë

nënshkruar diku 33 marrëveshje, por jo të gjitha janë zbatuar. Tani për tani të dyja vendet kanë synime të

ndryshme për marrëveshjen finale. Kosova insiston në njohje reciproke, kurse Serbia kërkon zgjidhje kompromisi.

## Shqipëria ndan një milion euro ndihma për Turqinë



Tiranë, 16 shkurt - Shqipëria do të japë një milion euro ndihmë për Turqinë pas tërmetit të 6 shkurtit që ka lënë mijëra njerëz të vdekur. Nga tërmetet mbi 7 shkallë të Rihterit në Turqi dhe Siri kanë vdekur mbi 39 000 persona.

Mbështetja financiare e Shqipërisë për Turqinë është bërë me dije nga kryeministri shqiptar, Edi Rama, gjatë një deklarimi për televizionin shtetëror turk.

Zyra e Kryeministrit ka thënë për mediet se Rama ka shprehur solidaritet me popullin e Turqisë dhe gjithë të prekurit nga tërmeti, raporton REL.

"Nuk do ta harrojmë kurrë atë që Turqia dhe [presidenti turk Rexhep Tajip] Erdogan bënë pas tërmetit të 2019-s [në Shqipëri]. Kemi vendosur ta mbështetim

popullin turk. Shpresojmë se familjet turke do ta kalojnë këtë falë solidaritetit. Shqipëria në emër të qytetarëve shqiptarë do të dhurojë 1 milion euro. E dimë që nevojiten shumë më tepër, por jemi pranë jush dhe japim çfarë të mundemi", ka thënë Rama.

Më 13 shkurt në Shqipëri është shpallur Ditë Zie Kombëtare në nderim të viktimave që ka shkaktuar tërmeti në kufirin turko-sirian.

Ndërkohë, para Bashkisë së Tiranës tash e disa ditë është vendosur një çadër, ku qytetarët mund të ofrojnë veshje dhe ushqime për t'i ndihmuar të prekurit nga tërmeti. Ndihmat që grumbullohen çdo ditë i dorëzohen Ambasadës së Turqisë në Tiranë, më pas organizohet transporti për t'i dërguar ato te personat që kanë nevojë.

## Memli Krasniqi takon deputetët e PDK-së që kishin nënshkruar Deklaratën e Pavarësisë

PRISHTINË, 16 SHKURT - "15 vjet më parë kisha fatin dhe nderin e madh jetësor që, së bashku me këto gra dhe burra, por edhe kolegë të tjerë, si deputetë të Partisë Demokratike të Kosovës, të marrim pjesë në shkrimin e historisë së re të popullit dhe shtetit tonë", ka shkruar në "Facebook" lideri i PDK-së Memli Krasniqi.

Ai ka theksuar se për të evokuar atë periudhë të papërsëritshme dhe për t'u shprehur mirënjohjen e thellë e falënderimin e përhershëm, në kuadër të aktiviteteve për Javën e Pavarësisë, ka takuar kolegët e

asaj legjislature historike. "Përmes nënshkrimit të Deklaratës së Pavarësisë, më 17 shkurt 2008, u jetësua një ëndërr shekullore e popullit tonë për liri, u shpaga sakrificat titanike e qytetarëve tanë dhe u përmbush edhe ideali i dëshmorëve të rënë në rrugën e lirisë. Përfundimisht mirënjohës veprimtarëve, intelektualëve, humanistëve, luftëtarëve, dëshmorëve, invalidëve të luftës dhe të gjithë atyre që në njërin apo tjetren mënyrë, mundësuan lirinë dhe pavarësinë e shtetit tonë. Qoftë e përjetshme Kosova!", ka shkruar Krasniqi.



FLET PËR "EPOKËN E RE", ADEM GRABOVCI

# 17 shkurti, kurorëzim i përpjekjeve ndër breza për liri dhe pavarësi

- Festa e 15-vjetorit të pavarësisë është e zbehtë pa liderët e UÇK-së dhe protagonistët kryesorë të 17 shkurtit

Një ndër nënshkruesit e Deklaratës së Pavarësisë, Adem Grabovci, ka thënë se 17 shkurti i vitit 2008 është kurorëzim i përpjekjeve ndër breza të popullit të Kosovës për liri dhe pavarësi. Grabovci në këtë intervistë për "Epokën e re" ka thënë se për 15 vjet shtet Kosova ka arritur shumë. Grabovci ka bërë me dije se festa e pavarësisë është e zbehtë pa liderët e UÇK-së të cilët gjenden në Hagë. "Personalisht jam i thyer shpirtërisht për mungesën e tyre fizike në këtë përvjetor për shkak se me ta kam rrugëtuar në angazhimin tonë të përbashkët për liri dhe pavarësi. Për mua ata janë ndër figurat më meritore të luftës dhe pavarësisë", ka thënë Grabovci

EPOKA  
ERE

Lirim GEÇI

PRISHTINË, 16 SHKURT -

**"Epoka e re":** Z. Grabovci, Kosova sot feston 15-vjetorin e pavarësisë. Si e kujtoni 17 shkurtin e vitit 2008 kur Kosova është bërë shtet?

**Grabovci:** 17 shkurti është festë e veçantë dhe kurorëzim i të gjitha përpjekjeve ndër breza të popullit tonë. Është fat, nder dhe kënaqësi për gjeneratën tonë që kemi pasur rastin historik të punojmë dhe të jemi aktorë të shpalljes së pavarësisë. 17 shkurtin e kujtoj si datën më të rëndësishme të historisë së Kosovës. Shpallja e pavarësisë në vetvete ngërthen shumë emocione, sidomos për ata që kanë kontribuar për këtë moment të paharrueshëm. Këtu e kam fjalën për gjeneratat e mëhershme, dëshmorët, luftëtarët e lirisë dhe të gjithë ata që kanë punuar paseshtur duke mos kursyer as jetën e tyre që të realizohet së pari liria dhe pastaj shpallja e Kosovës shtet i pavarur dhe sovran. Në këtë drejtim dëshmorët dhe të rënë për liri janë më meritoret për 17 shkurtin. Edhe pse dëshmorët kanë munguar fizikisht atë ditë, ata kanë qenë në mendjet dhe zemrat tona. Amaneti i tyre na obligon që ne të punojmë paseshtur që ta bëjmë Kosovën ashtu siç e kanë ëndërruar ata.

**"Epoka e re":** Çfarë ju ka shkuar në mendje atë ditë kur keni hedhur nënshkrimin në Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës?

**Grabovci:** Ne si popull kemi kaluar nëpër periudha të vështira, por edhe krenare për vendin. Personalisht flas për angazhimin tim të sinqertë në Aksionin e Pajtitit të Gjaqeve, i cili ka qenë parapërgatitje për luftën çlirimtare, e cila ka kulmuar me lirinë e Kosovës. Këto dy ngjarje historike, por edhe ngjarjet e mëhershme, janë gurthemel i shtetit të Kosovës. Kemi pasur

fatim që prijësit e këtyre ngjarjeve kanë ditur që t'i adresojnë qartë kërkesat e popullit për liri dhe pavarësi. Sigurisht, atë ditë me plot emocion dhe krenari kam kujtuar përpjekjet e popullit për liri, sakrificën e tyre, bashkëlufëtarët, dëshmorët, martirët dhe miqtë ndërkombëtarë të cilët kanë qenë me ne në ditët më të vështira. Personalisht kam pasur nderin të punoj me personalitet të shquara dhe historike. Falë tyre kemi arritur deri te 17 shkurti. Ardha deri te kjo datë nuk ka qenë e lehtë, por shumë e vështirë dhe gjithmonë do të mbetet në kujtesën time si një ndër momentet më të lumtura dhe krenare të jetës sime. Krejt ky rrugëtim nuk mund të përshkruhet me një fjalë ose fjali sepse rruga jonë për liri dhe pavarësi ka qenë e gjatë dhe përplot sakrificë.

**"Epoka e re":** Sa është zhvilluar dhe forcuar Kosova në këto 15 vjet shtet?

**Grabovci:** 15 vjet pas shpalljes së Pavarësisë është e vërtetë se kanë ndodhur dhe janë zhvilluar ngjarje tepër të rëndësishme. Janë krijuar vepra të jashtëzakonshme të cilat është duke i shijuar çdo qytetar i republikës së Kosovës. Ne duhet ta rikthejmë kujtesën tonë dhe të shohim se ku kemi qenë dhe ku jemi sot. Dhe nëse duam të japim një konstatim të drejtë, korrekt dhe duke përdorur metodën krahasuese në këtë vend janë bërë vepra të mëdha pikërisht nga ata që mbi supet e tyre kanë bartur luftën për çlirim. Vetëm duhet të ndalemi dhe ta analizojmë se ku kemi qenë para pavarësisë dhe ku jemi sot. Kosova para 15 vjetësh ka qenë duke u përballur me pasojat e luftës dhe duke e sanuar një gjendje e cila ka qenë jashtëzakonisht e rëndë. Të gjithë e dinë se Kosova ishte e shkatërruar nga lufta, por falë vendosmërisë sonë kemi arritur



ta zhvillojmë dhe forcojmë shtetin. Ndryshimet nuk mund t'i mohojë askush, por sigurisht se është mundur të bëhet më shumë. Siç e dini, Kosova ka nisur nga zeroja, por falë angazhimit tonë të përbashkët kemi arritur t'i ndërtojmë institucionet dhe ta shpallim pavarësinë. Tash na mbetet të angazhohemi për fuqizimin e shtetit, anëtarësimin e tij në NATO, OKB dhe Bashkim Evropian (BE). Me këtë rast dua t'i falënderoj partnerët tanë evropianë, mbi të gjitha Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), të cilat kanë bërë shumë për vendin tonë, duke na u gjendur afër edhe në çastet më të vështira kur luftohej për jetë a vdekje. Mbështetja amerikane ka qenë vendimtare për liri dhe pavarësi. Kjo mbështetje ka ardhur për shkak se lufta jonë e udhëhequr nga UÇK-ja ka qenë e pastër dhe e drejtë. Falë kësaj lufte të drejtë dhe të pastër për herë të parë kemi gëzuar edhe mbështetjen e aleatëve tradicionalë të Serbisë, të cilët e kishin parë se shteti serb është shtet gjenocidal. Prandaj rrugëtimi ynë deri këtu është meritë edhe e miqve tanë, por meritat kryesore i ka populli lirishtdashës i Kosovës.

**"Epoka e re":** Kur jemi te 15-vjetori i pavarësisë, a është Kosova në rrugën e duhur me këtë udhëheqje shtetërore?

**Grabovci:** Çdo qytetar, natyrisht edhe unë, do të doja që Kosova ta ketë një qeveri të përgjegjshme dhe të vetëdijshme për përgjegjësinë historike që ka karshi procesit të dialogut dhe

sfidave me të cilat është duke u ballafaquar populli ynë. Uroj që kjo qeveri të këndellët sa më shpejt që të jetë e mundur dhe t'i kryejë detyrat e veta për çfarë ka marrë besimin e qytetarëve. E them me keqardhje për këto dy vjet, absolutisht kjo qeveri bie nëndesh me të gjitha interesat dhe përcaktimet e popullit dhe kauzës sonë shtetërore.

**"Epoka e re":** Z. Grabovci, sa e zbehtë këtë përvjetor mungesa e liderëve të UÇK-së dhe protagonistëve kryesorë të shpalljes së pavarësisë të cilët janë duke u ballafaquar me drejtësinë në Hagë?

**Grabovci:** Është shumë e vërtetë se ky përvjetor është i zbehtë pa ta dhe vërehet mungesa e tyre e madhe. Çdo qytetar që mendon drejt dhe pa emocione i mungojnë protagonistët e lirisë dhe pavarësisë. Ata që mendojnë për familjen e tyre, shtetin dhe atdheun, i kanë zemrat e lënduara për mospraninë e tyre në 15-vjetorin e tyre. Personalisht jam i thyer shpirtërisht për mungesën e tyre fizike në këtë përvjetor për shkak se me ta kam rrugëtuar në angazhimin tonë të përbashkët për liri dhe pavarësi. Për mua ata janë ndër figurat më meritore të luftës dhe pavarësisë. Kjo mund të mos i pëlqejë ndonjë shpirtligu, por ky është realiteti që nuk mund ta ndryshojë askush sepse ata na kanë udhëhequr drejt çlirimit dhe drejt shpalljes së pavarësisë. Në këtë drejtim ndaj Kosovës dhe atyre që janë në Hagë është duke u bërë një padrejtësi, e cila është më e madhja në historinë e shtetit tonë. Drejtësia vendore dhe

ndërkombëtare është duke bërë padrejtësi ndaj çlirimtarëve, të cilët kanë dhënë gjithçka nga vetja e tyre që Kosova të jetë e lirë dhe shtet i pavarur. Akuzat me të cilat po përballen ata janë absurde. Të gjithë e dinë se lufta e UÇK-së dhe e protagonistëve të saj ka qenë e drejtë dhe e pastër. Këtë që e them do ta vërtetojë e ardhmja. Nëse ka krim në drejtësi, ky është krimi më i madh ndaj drejtësisë duke i mbajtur në burg ata të cilët kanë qenë të angazhuar me krejt qenien e tyre për çlirim nga okupatori. Populli i Kosovës ka luftuar për mbijetesë dhe kjo që është duke ndodhur sot është e padrejtë. Pavarësisht kësaj, jam shumë i bindur që do ta tejkalojmë edhe këtë sfidë dhe i uroj qytetarët e Kosovës për këtë festë, me thirrjen që të gjithë t'i thërrasin ndërgjegjes së tyre humane dhe kombëtare që të jenë korrektë me UÇK-në.

**"Epoka e re":** Cili është mesazhi juaj për Thaçin, Veselin, Selimin, Krasniqin etj., për 15-vjetorin e pavarësisë?

**Grabovci:** Mesazhi im për ta është që të qëndrojnë ashtu siç janë duke qëndruar: të fortë si gjithnjë. Ata janë krenarë për luftën çlirimtare siç është krenar çdo qytetar i ndershëm i këtij vendi. Fati e ka dashur që ata edhe njëherë të përballen me një sfidë të cilën nuk e kanë merituar. Prandaj në fund më lejoni t'juaj uroj 15-vjetorin e pavarësisë, duke prituri që shumë shpejt do të kthehen në atdheun tonë të përbashkët për të cilin kanë një kontribut historik.

# A ofron “superpuna” punësim të qëndrueshëm?



**PRISHTINË, 16 JANAR** - Platforma “superpuna”, e krijuar nga Qeveria e Kosovës, me qëllim rritjen e punësimit të të rinjve, nuk është një nismë e qëndrueshme, thotë profesori i Ekonomisë dhe Financave në Universitetin e Prishtinës, Ujkan Bajra. “E shoh më shumë si pjesë të marketingut politik se, kinse, qeveria është duke punuar për uljen e papunësisë apo për krijimin e politikave të favorshme që stimulojnë punësimin. Fakti që është për gjashtë muaj nuk siguron qëndrueshmëri afatgjatë”, thotë Bajra për “Radion Evropa e Lirë”. Platforma “superpuna” u vu në funksion më 6 shkurt. Në kuadër të saj, Qeveria e Kosovës subvencionon punëdhënësin duke paguar pagën e punëtorit për gjashtë muaj, në vlerë prej 264 eurosh. Punëdhënësi, pastaj, ka të drejtë ta shtojë vlerën e pagës për punëtorin e angazhuar.

Pas periudhës gjashtëmuajore, punëdhënësi mund ta mbajë në punë punëtorin duke nënshkruar kontratë të re, por edhe mund ta shkarkojë. Bajra thotë se pas kësaj periudhe çdo gjë mbetet në dorën e punëdhënësit. Ai kujton se Kosova ka tashmë Agjencinë Shtetërore të Punësimit, e cila, sipas tij, ka rol të ngjashëm me

platformën “superpuna” dhe nuk ka ndikuar mjaftueshëm në zbutjen e papunësisë. Kjo agjenci, e cila vepron që nga viti 2017, i aftëson punëkërkuarit pa pagesë.

## Sa është shkalla e papunësisë në Kosovë?

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), shkalla e papunësisë në vend është mbi 20 për qind. Të dhënat e ASK-së për tregun e punës në vitin 2021, të cilat janë të fundit, tregojnë se janë mbi 1.2 milion qytetarë të Kosovës në moshë pune. Prej këtyre, mbi 380 mijë janë të punësuar, mbi 100 mijë janë të regjistruar si të papunë, ndërsa mbi 740 mijë janë ekonomikisht joaktivë, që do të thotë se nuk janë të punësuar, as të regjistruar si të papunë dhe as nuk kërkojnë punë.

Te të rinjtë e moshës 15-24 vjeç, shkalla e papunësisë është 38 për qind.

## Çfarë ofron platforma “superpuna”?

“Superpuna” u dedikohet personave të papunë të moshës 18 deri në 25 vjeç. Punëdhënësi nga sektorë të ndryshëm kanë nisur të publikojnë aty ofertat e tyre për punë.

Brenda një jave janë ofruar rreth 500 vende pune nga mbi 300 punëdhënësit.

Pozitat e ofruara përfshijnë: kamerier, asistent të shitjes, elektrikist, gazetar, kontabilist, dizajner grafik, infermier e të tjera.

Pagat që i ofrojnë punëdhënësit nisin nga 264 euro - sa është subvencionimi nga qeveria - deri mbi 1 000.00 euro, varësisht nga pozita e punës.

Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve i Kosovës, Hekuran Murati, ka thënë se deri më 12 shkurt numri i punëkërkuarve të regjistruar në këtë platformë ka kaluar mbi 1 000.

Ministria që udhëheq ai vepron si ndërmjetësuese midis punëdhënëseve dhe punëkërkuarve, por ajo nuk ka dhënë detaje nëse, deri më tash, është bërë ndonjë ndërmjetësim.

Punëkërkuari nuk duhet të ketë qenë i punësuar në tre muajt e fundit, para regjistrimit në platformën “superpuna”, ndërsa punëmarrësi obligohet t'i përmbushë të gjitha dispozitat e Ligjit të Punës.

## Krasniqi: Subvencionim i ulët

Skënder Krasniqi, drejtor i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë në Prishtinë, thotë

se në këtë formë bizneset nuk mund të krijojnë punësim të qëndrueshëm. Për një gjë të tillë, sipas tij, do të duhej përkrahje më e madhe nga shteti. “Bizneseve u duhet infrastrukturë më e mirë ligjore, dhënie e më shumë fondeve dhe kredive në periudha kthimi shumë më të gjata e me norma interesi më të ulëta, përkrahje financiare për rritje të eksportit... Qeveria duhet të punojë, po ashtu, në arsimimin më të mirë të studentëve për tregun e punës”, thotë Krasniqi për “Radion Evropa e Lirë”. Subvencionimi prej 264 eurosh, sipas tij, është i vogël. “Kërkesat e punëtorëve për paga janë shumë më të mëdha se shumata e subvencionuar nga qeveria dhe, patjetër, bizneset duhet ta rritin atë pagë”, thotë Krasniqi.

Paga mesatare në Kosovë deri vonë ka qenë rreth 480 euro. Në fillim të shkurtit ka hyrë në fuqi Ligji i ri për Paga, i cili u ka sjellë rritje gati të gjithë punonjësve të sektorit publik. Autoritetet kanë thënë se me këtë ligj paga mesatare do të arrijë deri në 730 euro.

## Çfarë synon qeveria?

Ministri Murati, kur ka vënë në funksion platformën

“superpuna” më 6 shkurt, ka thënë se synim i autoriteteve është që në vitin e parë të punësojnë mbi 10 mijë të rinj. Të rinjtë që do të punësohen, ka thënë Murati, do të aftësohen dhe do të fitojnë përvojë pune. Më pas, ka shtuar ai, ata do të mund të bëhen pjesë afatgjatë e kompanive ku punojnë, apo të gjejnë punë më lehtë në ndonjë kompani tjetër.

Vitin e kaluar Qeveria e Kosovës ka zbatuar disa skema të cilat kanë pasur synim punësimin e grupeve të ndryshme shoqërore, përfshirë gratë, personat me aftësi të kufizuara dhe familjet që nuk kanë pasur asnjë anëtar të punësuar.

Përmes këtyre skemave, sipas Qeverisë së Kosovës, janë punësuar afër 5 000 gra e vajza, 239 persona me aftësi të kufizuara dhe 770 familje janë bërë me një anëtar të punësuar.

Vitet e fundit tregu i Kosovës është përballur edhe me mungesë punëtorësh, sidomos sektori privat. Sipas disa anketave që ka realizuar “Radio Evropa e Lirë”, por edhe të dhënave të Inspektoratit të Punës, qytetarët janë ankuar për paga të ulëta, mosrespektim të orarit të punës, privim nga pushimi etj. Për rrjedhojë, shumë punëdhënësit kanë marrë punëtorë nga jashtë.



# Dinastia Rameside: Një epokë e artë në Egjiptin e Lashtë



Përgjatë historisë së tij shumë të gjatë, fati i Egjiptit të lashtë është vendosur gjithnjë nga dinastitë e mëdha sunduese. Një shtet dhe perandori e fuqishme ka nevojë për një sundimtar po aq të fuqishëm. Dhe që nga bashkimi i Egjiptit të Poshtëm dhe atij të Sipërm dhe themelimi i Dinastisë së Parë rreth vitit 3000 Para Krishtit, kjo perandori e lashtë ka pasur zakonisht një lider të fortë në krye të saj.

Kur kjo gjë nuk ndodhte, ajo zhrytej në kaos dhe ishte shumë e brishtë. Praktika e dinastive të fuqishme vazhdoi për mijëra vjet. Një nga dinastitë më të fuqishme që bie në sy në historinë e Egjiptit është Dinastia XIX-të, e njohur edhe si Dinastia Rameside. Po cilët ishin faraonët më të mëdhenj të kësaj epoke? Dhe çfarë i bëri ata kaq të veçantë? Bashkimi i Egjiptit të Sipërm dhe atij të Poshtëm, ishte një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e lashtë. Ajo arritje diplomatike dhe ushtarake i atribuohet përgjithësisht Faraonit Narmer dhe daton rreth vitit 3100 Para Krishtit, një kohë vërtet e hershme sa i përket formimit të qytetërimeve më të vjetra në botë.

Nëpërmjet atij bashkimi, Narmer themeloi Dinastinë e Parë të Egjiptit dhe filloi diçka që do të ndikonte tek fillimet e botës së qytetëruar. Përgjithësisht pranohet se Egjipti është sunduar nga 34 dinasti të tilla, derisa u pushtua dhe u bë pjesë fillimisht e Perandorisë Romake dhe më vonë e pushtuesve të tjerë.

Disa ishin të mira, të tjera ishin të shkëlqyera, dhe të tjerët ishin thjesht më të këqij. Dhe çdo dinasti prodhoi disa faraonë vërtet legjendarë. Një dinasti që la shumë gjurmë në historinë e Egjiptit ishte Dinastia XVIII-të. Në atë kohë Egjipti arriti kulmin e fuqisë dhe dominimit të tij në rajon.

Ai mbajti armiq të larg dhe e zgjeroi shumë ndikimin e tij. Sundimi i kësaj dinastie filloi rreth vitit 1550 Para Erës Sonë dhe përfundoi në vitin 1292 Para Erës Sonë. Por pse përfundoi një periudhë kaq e fuqishme? Thuhet shpesh se epokat e mira dhe të begata prodhojnë sundimtarë gjithnjë e më të këqij. E vërteta është se në atë periudhë u ngjiti në pushtet faraoni Akhenaten, një udhëheqës i fuqishëm, por i çuditshëm, i cili u përpoq të reformonte tërësisht fenë e vjetër të kombit të tij. Akhenateni imponoi adhurimin e Diellit, duke nxitur shumë zemërimin e njerëzve. Egjipti u përça, u përfshi në trazira të brendshme dhe u dobësua.

Populli nuk ishte gati për ndryshime aq të mëdha. Kur Akhenaten vdiq, trashëgimtari dhe pasardhësi i tij, Tutankhamun, u përpoq të zhbënte ndryshimet rrënjësore të babait të tij. Por ai ishte një fëmijë shëndetlig për shkak martesave të shumta brenda fisit, ndaj dhe mbretërimi i tij ishte relativisht i shkurtër.

Duke pasur asnjë fëmijë për t'ia lënë trashëgim fronin, Tutankhamun u pasua nga

këshilltari i tij i ngushtë Keperkheperure Ay. Ai kishte plane të mëdha për të vazhduar Dinastinë XVIII. Por vdiq pas vetëm 4 vite sundim, dhe në vend të tij u ngjiti një burrë pa asnjë lidhje me dinastinë mbretërore të mëparshme.

Horemheb e mori kurorën përmes martesës. Gruaja e tij ishte një nga vajzat e Ay. Ky faraon shkëlqeu në rolin e tij. Ai bashkoi një shtet të përcarë, e stabilizoi atë dhe nisi një fushatë për fshirjen e gjurmëve të paraardhësve të tij. Ai shkatërroi tempujt dhe statujat e Akhenaten, ripërdori monumentet e Ay dhe Tutankhamun, dhe fshiu ngadalë kujtesën e reformave të tyre fetare.

Horemheb mbretëroi për 14 vite dhe të gjithë menduan se Dinastia XVIII do të vazhdonte pas tij. Por kjo gjë nuk ndodhi. Faraoni nuk la pas djem, dhe në vend të tij emëroi aleatin dhe zëvendësimin e tij, Paramesin. Ashtu si Horemheb, Paramesi nuk ishte me origjinë mbretërore. Gjithsesi familja e tij ishte shumë e njohur për kohën, dhe nga vezir ai u bë faraon. Me ngjitjen në fron, i vuri vetes një emër mbretëror: Menpehtir Rameses I, ose Ramesis I. Dhe me të filloi Dinastia XIX e famshme e Ramesidëve. Me Ramesin I, filloi një periudhë e re e historisë së lashtë egjiptiane.

Ramesis ishte tashmë i moshuar kur u bë faraon, dhe kishte një djalë dhe një nip. Mbretërimi i tij ishte i shkurtër. Zgjati vetëm një

ose dy vjet, para se të vdiste. Ai u pasua nga djali i tij, Seti, që mori emrin Menmaat Seti I. Edhe atij, iu desh të korigjonte pasojat e këqija të mbretërimit të diskutueshëm të Akhenatenit.

Por pati shumë sukses në këtë aspekt dhe mbretëroi për rreth 15 vjet si një mbret i fuqishëm dhe dominues. E konsolidoi perandorinë dhe u fokusua në rikonfirmimin e ndikimit mbi Sirinë dhe Kanaanin, dy rajone që ishin vazhdimisht në presionin e Perandorisë Hitete fqinje, një nga armiq të tradicionalë të Egjiptit.


Për shkak të kësaj, Seti I kreu disa fushata të mëdha ushtarake kundër hititëve në veri. Shumica e betejave përfunduan me fitoren e Egjiptit. Megjithatë ai nuk ia doli të thyehte fuqinë e Perandorisë së madhe Hitite. Gjithsesi arriti të ripushtojë shumicën e territoreve që u prekën nga lufta, dhe e rikonfirmoi dominimin e Egjiptit në rajon.

Seti vdiq në 1279 Para Krishtit dhe u varros në një varr luksoz në Luginën e Mbretërve. Por e gjithë madhështia dhe fuqia e tij do të mbetej në hije nga djali dhe trashëgimtari i tij, Ramesis II, i cili do të bëhej një faraon edhe më i mirë se i ati. Duke mbajtur emrin e gjyshit të tij, Ramesis II fitoi epitetin "I Madh" dhe konsiderohet si faraoni më i famshëm dhe më i fuqishëm i periudhës së Mbretërisë së Re, e cila është epoka e artë e Egjiptit të lashtë.

Pjesa e parë e sundimit të tij iu

kushtua ndërtimit të tempujve, monumenteve, madje edhe qyteteve të reja mbresëlënëse për kohën Ai ndërtoi Pi-Ramesses, kryeqytetin e tij të ri që shtrihej në deltën e Nilit, nga i cili do të kryente fushatat e tij të reja ushtarake. Dhe punimet u kryen shumë shpejt, pasi Ramesis II synonte të ripushtonte territoret që tashmë kontrolloneshin nga hititët, nubianët dhe fiset libiane. Ai depërtoi thellë në Nubi, Siri dhe Kanaan, duke i shkatërruar armiq të tij dhe duke i mbajtur kufijtë e Egjiptit të sigurt nga kërcënimet e Popujve të Detit. Kudo që lindnin kërcënime, Ramesis i Madh i përballoi ato me efikasitet dhe vendosmëri. Fuqia e ushtrisë së Egjiptit të lashtë arriti kulmin pikërisht gjatë mbretërimit të Ramesis II. Ajo numëronte rreth 100.000 burra, që shifër e jashtëzakonshme për një epokë kaq të lashtë. Dhe ishte ai numër kaq i madh që i mbajti armiq të larg dhe e forcoi ndikimin e Egjiptit. Ramesis i Madh mbretëroi për shumë kohë, dhe vdiq diku në vitin e 90-të apo të 91-të të jetës së tij. Ai u pasua nga djali i tij i 13-të, Mernepta. Mbretërimi i tij ishte mjaft i qetë kur krahasohej me babanë ose gjyshin e tij, dhe zgjati jo më shumë se 10 vjet. Me vdekjen e tij, nisi një rënie graduale e fuqisë dhe madhështisë së Dinastisë XIX Rameside.

Marrë me shkurtime nga  
Ancient Origins – Bota.al



Veton Zymberi, redaktor i sportit

## 'Dardanet' triumfuan ndaj Estonisë

**PRISHTINË, 16 SHKURT** - Vashat e Përfaqësueses së Kosovës A që po marrin pjesë në turneun miqësor "Turkish National Womens Cup Alanya 2023" kanë triumfuar në ballafaqimin e parë kundër Përfaqësueses së Estonisë me rezultat 2-1. Në pjesën e parë vashat tona,

ndonjëse pësuan gol qysh në minutën e 16 përmes Kubassoves, nuk e humbën përqendrimin, por hapën lojën dhe radhitën sulmet në portën rivale. Ky angazhim i madh solli rezultat pasi në minutën e 33-të Elizabeta Ejupi barazoi shifrat në 1-1, me të cilin rezultat edhe u

përmbyll pjesa e parë. Në vazhdim dardanet e nisën furishëm lojën dhe me sulme të pareshtura drejt portës estone krijuan një mori rastesh shënimi. U dallua sidomos kapitenia Erëleta Memeti, e cila shënoi gol në minutën e 67, duke e kaluar Kosovën në epërsi 2-1. Deri

në fund të ndeshjes dardanet krijuan edhe disa raste shënimi, ndërsa Estonia, me gjithë orvatjet, nuk arriti të bëjë diçka më shumë. Kjo fitore është stimul për vashat e Kosovës për ndeshjen e radhës. Ndeshjen e dytë Kosova do ta zhvillojë më 18 shkurt kundër Honkongut në



orën 11:00 sipas kohës lokale (ora 9:00 me kohë të Kosovës).

## Pensionohet katër herë futbollisti më i mirë në Kosovë, Mentor Zhdrella

Futbollisti më i trofeshëm në nivelin personal në futbollin e Kosovës, Mentor Zhdrella, i cili është shpallur katër herë lojtari më i mirë i vitit, të enjten edhe zyrtarisht është tërhequr nga futbollin. "Ndiej kënaqësi të jashtëzakonshme kur kthej kokën mbrapa dhe shikoj atë çfarë kam bërë në futboll në 20 vitet e kaluara, ku kam bërë shoqëri fantastike dhe shumë trofe të fituara si dhe suksese individuale të arritura", ka thënë Zhdrella

**EPOKA ERE****Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 16 SHKURT** - Katër herë futbollisti më i mirë në Kosovë, Mentor Zhdrella, është pensionuar edhe zyrtarisht nga futbollin. Mesfushori i talentuar në kohët e fundit është përballur me shumë lëndime, kurse të enjten ka vendosur ta bëjë publik lajmin për tërheqjen nga futbollin. Ai është shprehur i lumtur me të arriturat që ka

pasur në si në aspektin individual ashtu edhe me klubet nëpër të cilat ka luajtur. "Çdo fillim e ka fundin e vet. Edhe karrierës time si futbollist i erdhi fundi. Ndiem jashtëzakonisht i lumtur sepse kam arritur ëndrrën time për ta luajtur sportin që dua. Ai më dha disa nga momentet më të mira të jetës sime, më ka dhuruar shumë kënaqësi dhe suksese. Ndiej kënaqësi të jashtëzakonshme kur kthej



kokën mbrapa dhe shikoj atë çfarë kam bërë në futboll në 20 vitet e kaluara, ku kam bërë shoqëri fantastike dhe shumë trofe të fituara si dhe suksese individuale të arritura", ka thënë Zhdrella.

Hapat e parë në futboll Zhdrella i nisi në skuadrën e 2 Korrikut nga Prishtina. Ai falënderoi këtë klub që i mundësoi ta jetësojë ëndrrën si futbollist, derisa nuk harroi t'i falënderojë edhe klubet e tjera ku ka luajtur. "Dua t'i

falënderoj të gjithë ata që kanë qenë pjesë e karrierës sime, të gjithë trajnerët, klubet ku kam luajtur, të gjithë bashkëlojtarët, fansat, anëtarët e familjes dhe miqtë. I jam gjithmonë mirënjohës klubit të 2 Korrikut, aty ku fillova ta jetësoj ëndrrën. Po ashtu, e paharruar në memorien time, do të mbetet epoka që kam kaluar me Prishtinën, Hysin, Dritën, Feronikelin, Llapin, Dukagjinin e KEK-un si dhe kulminacioni i krenarisë që ishte fanella e kombëtares së Kosovës", ka shtuar Zhdrella.

Në kohën kur Zhdrella ishte në kulmin e karrierës, futbollin e Kosovës ende nuk ishte i pranuar ndërkombëtarisht dhe kalimi në klubet evropiane ishte më i vështirë, por kjo nuk është asnjë pengesë që Zhdrella ta ketë fituar epitetin e legendës në futbollin e Kosovës.

## Luiza Gega, ministres Kushi: Rishikoje buxhetin!

**TRANË, 16 SHKURT** - Mungesa e transparencës, vonesat në lëvizimin e fondeve, ulja e buxhetit për sportin dhe ndarja sipas një sistemi pikëzimi, ka sjellë debate dhe pakënaqësi mes federatave dhe vetë protagonistëve. Ministria e Arsimit dhe Sportit ka vendosur një fond prej 1 miliard e 494 milionë lekësh të vjetër për 17 federatat e shumësportëshit në Shqipëri për vitin 2023, një shumë kjo më e ulët në raport me një vit më parë, 1.8 miliard, i shpërndarë në dy këste. Jo vetëm buxheti i reduktuar,



mënyra e shpërndarjes gjithashtu është jashtë logjike. Federata e Mundjes, e cila është

e vetmja Federatë që ka sjellë një medalje të artë në Botëror, merr 121 milionë lekë të vjetër

në vit, disa milionë më shumë se Federata e Taekwondosë e cila përfiton 111 milionë lekë nga ky buxhet, ndërsa dy vjet më parë përfitonte vetëm 50 milionë. Rritje të madhe ka pësuar edhe Federata e Çiklizmit, me 133 milionë lekë, federata e katërt më e paguar. Një rënie ka pësuar edhe Federata e Atletikës, e cila për vitin 2023 do të përfitojë 100 milionë lekë. Kjo ulje në buxhet nuk është pritur mirë nga kampionia e Evropës, Luiza Gega, e cila ka reaguar me anë të një postimi në rrjetet sociale.

"Sinqerisht, kam vërtet përshtypjen që ministria Evis Kushi s'ka dijeni për këtë logjikën e ndarjes së këtij buxheti. Shpresoj që ta shikojë sa më shpejt. Personalisht si sportiste elitare nuk kam ndonjë interes sado që të jetë buxheti i Federatës, por duke qenë se ai ndahet nga performanca që kanë pasur sportistët vitin e kaluar, ndihem e ofenduar që Federatës sime, në vend se t'i ngrihej buxheti, përkundrazi, u është ulur edhe disa federatave të tjera", shkruan Luiza Gega.

## Galtieri mund të shkarkohet më 8 mars

**PARIS, 16 SHKURT** - Tri humbje radhazi, kundër Marseilles në Kupën e Francës, Monacos në Ligën 1 dhe Bayern Munchenit në Ligën e Kampionëve, kanë shkaktuar jo

pak telashe për trajnerin e Paris Saint-Germainit, Christophe Galtier. Në kryeqytetin francez projekti për fitimin e Ligës së Kampionëve nisi që në vitin 2011, por asnjëherë deri më

tani nuk është realizuar. Sipas informacioneve të raportuara nga shtypi transalpin, Galtier do ta drejtojë ekipin të paktën deri në ndeshjen e kthimit kundër Bayernit më 8 mars. Pas

kësaj date çdo gjë mund të ndodhë, veçanërisht nëse rezultatet nuk përmirësohen. Si zëvendësues të tij përmenden Zinedine Zidane dhe Thomas Tuchel.



## Mourinho, Romës: Në qershor është vonë për bisedime

ROMË, 16 SHKURT - Trajneri Jose Mourinho u ka dhënë një mesazh të qartë drejtuesve të Romës për të ardhmen e tij. Portugezi po kalon vitin e tij të dytë te Roma dhe ka kontratë me klubin italian deri në

verën e vitit 2024. Por e ardhmja e tij vazhdon të jetë e paqartë pasi "Special One" kërkon garanci për të ardhmen nga klubi. Dëshira Mourinho është të ndërtojë një skuadër të fuqishme që të

luftojë për titullin e kampionit në sezonin e ri. "Drejtuesit e klubit i dinë kërkesat e mia dhe duhet të më japin më herët siguri. Por qershori është shumë vonë për mua", ka thënë Mourinho. Ky është

një alarm i madh për Romën, pasi nëse do ta mbajë portugezin, duhet të reagojë më shpejt. Edhe Paulo Dybala i ka bërë të qartë klubit se dëshiron të qëndrojë, por vetëm me Mourinhon trajner.



## Lakersat u rikthehen fitoreve, Denveri vazhdon të dominojë

LOS ANXHELOS, 16 SHKURT - Denveri gjithnjë i vetëm në krye të renditjes në Konferencën e Perëndimit pas fitores me rezultat 118-109 ndaj rivalëve të Dallasit. Kolektiviteti i Denverit bëri dallimin, me 6 lojtarë që realizuan mbi 10 pikë. Green me 24 pikë e Porteri me 22 ishin shënuesit më të mirë, ndërsa Nikola Jokiqi realizoi një "triple double", me 14 pikë, 13 rebounde dhe 10 asistime. Për Dallasin u dallua Luka Donçiqi me 37 pikë, por që mbetën për statistikë. Në Lindje kryeson skuadra e Bostonit, që rikthehet te fitorja, duke mundur me rezultat 127-



### REZULTATET

Charlotte - San Antonio	120-110
Indiana - Chicago	117-113
Atlanta - New York	101-122
Boston - Detroit	127-109
Brooklyn - Miami	116-105
Philadelphia - Cleveland	118-112
Memphis - Utah Jazz	117-111
Oklahoma - Houston	133-96
Denver - Dallas	118-109
Lakers - New Orleans	120-102

109 Detroitin. Tatum me 38 pikë e Brogdoni me 25 bënë dallimin në fushë për Celticsin. Pas tri humbjesh fiton edhe ekipi i lakersave, që mundi me rezultat 120-102 New Orleansin. Për kalifornianët u dalluan Davis me 28 pikë si dhe Russell e LeBron Jamesi me nga 21 pikë secili. Fiton edhe ekipi i Brooklynit, që mundi me rezultat 116-105 Miamin, dy ekipe që luajnë për

një vend në "play-off". Mikal Bridges ishte lider në fushë për Netsin, duke realizuar 45 pikë. Nuk zhgënjën Philadelphia, që mundi me rezultat 118-112 Clevelandin. Joel Embiid realizoi 29 pikë e 14 rebounde, duke i bërë të pavlefshme 33 pikët e Mitchellit për miqtë. Memphis, falë 50 pikëve të dyshes Jackson - Bane, mundi 117-111 Utah Jazzin.

## Wolff: Hamiltoni nuk dëshiron të largohet

LONDËR, 16 SHKURT - Edhe pas paraqitjes te Mercedesi, e ardhmja e pilotit britanik Lewis Hamilton është ende e paqartë. Kontrata e shtatë herë kampionit të botës në Formula 1 me makinën gjermane skadon në fund të këtij viti dhe ende nuk është vendosur nëse ai do të qëndrojë apo jo. Zhgënjimi i vjetshëm, ku Mercedesi ishte shumë pas rivalëve, ka lëkundur disi pozitativ mes palëve. Gjithsesi, Toto Wolff ka folur për të ardhmen e britanikut, duke sqaruar se, sipas tij, nuk ka asnjë arsye që palët të divorcohen. "Kam pasur një bisedë të parë me Lewisin në lidhje me të ardhmen e tij, por nuk dua të vendos asnjë



fat në lidhje me këtë çështje. Viti është ende i gjatë, ndaj do ta gjejmë momentin e duhur për të diskutuar e vendosur për gjithçka", ka thënë Wolff. "Lewis është një person pozitiv dhe me energji në këto momente. Ky mund të jetë versioni më i mirë i tij që kam parë

vitet e fundit. Vjet gjërat shkuan keq, por Lewis i di kapacitetet e skuadrës dhe nuk ka dyshime se ne dëshirojmë që ai të qëndrojë. Madje e dimë se ai nuk dëshiron të largohet. Për ne, mosha nuk ka rëndësi, pasi ai mund të kalojë çdo limit", ka deklaruar Wolff.

### REZULTATET

Milwaukee - Boston	131-125
Toronto - Orlando	123-113
Phoenix - Sacramento	120-109
Clippers - Golden State	134-124
Portland - Washington	101-126

### SHKURT

#### Manaj, afër rikthimit tek Albacete

Pasi ndërpreu kontratën përkohësisht me Watfordin, duke gjetur një gjuhë të përbashkët për të mirën e të dy palëve, Rei Manaj është në kërkim të një ekipi që të mbyllë këtë sezon, i cili deri tani nuk ka shkuar në mënyrën e duhur. Sulmuesi, i cili për më tepër është edhe i dëmtuar, pritët që të kthehet në fundin e muajit mars me shumë mundësi. Lajmet nga Spanja vijnë se Manaj është pranë rikthimit tek Albacete, klubi i kategorisë së dytë, ku lushnjari ka qenë pjesë përpara disa sezonesh. Albacete ndodhet në vendin e gjashtë në kampionat dhe aktualisht në vendin që shkon në "play-off" dhe drejtuesit e klubit spanjoll besojnë se shërbimet e 25-vjeçarit mund t'u vijnë në ndihmë për pjesën e mbetur të kampionatit.

#### Guardiola: Nëse do të fitonte Arsenali do të mbyllej gara për titull

Manchester City ka marrë fitore të madhe në udhëtim tek Arsenali me rezultat 1-3, por në rast se Arsenali do ta fitonte këtë ndeshje, do të bëhej shumë më e vështirë për Cityn ta mbronte titullin e kampionit. Këtë e ka pranuar edhe trajneri Pep Guardiola që ka thënë se fitorja e mundshme e Arsenalit do ta mbyllte garën për trofeun në Angli. "Nuk është kurrë e lehtë të luash kundër Arsenalit. Ai është ekip i madh. Dallimin e bëri cilësia e djemve të mi. Edhe në kohët e vështira ne qëndruam të fokusuar dhe brenda ndeshjes. Nëse do të kishim humbur, lufta për titull do të ishte pothuajse e mbyllur", ka deklaruar Guardiola.

#### Chelsea pësoi humbje nga Dortmundi, Potteri lavdëron lojtarët

Chelsea pësoi nga Borussia Dortmundi (1-0) në 1/8 e finales në Ligën e Kampionëve. Pavarësisht prej kësaj humbjeje, trajneri Graham Potter i ka lavdëruar lojtarët e tij. "Lojtarët kanë punuar shumë mirë. Reagimi i tyre si grup është i mirë dhe në ushtrime kanë qenë fantastikë. Ky ekip ka shpirt. Vetëm se na duhet pak fat, të vazhdojmë me nivelin e performancës si në këtë ndeshje dhe pastaj të shkojmë duke u përmirësuar", ka deklaruar Potter.

#### Arteta: Besoj se mund ta fitojmë titullin

Trajneri i Arsenalit, Mikel Arteta, edhe përkundër humbjes nga Manchester City (1-3), ende beson në titullin e kampionit në Premierë Ligë. "Ne i shkaktuar probleme të ndryshme Cityt. Fakti që kemi humbur nuk e di nëse varet nga mungesa e përvojës apo e fatit. A mendoj ende se mund ta fitojmë kampionatin? Po, kam shumë besim te djelmoshat e mi, edhe pas kësaj ndeshjeje", ka deklaruar Arteta. City e mori primatin në tabelë dhe ka pikë të njëjta me Arsenalin, i cili, megjithatë, e ka një ndeshje më pak të zhvilluar.

## Scaloni rinovon kontratën me Argentinën

Lionel Scaloni pritët ta rinovojë kontratën me Argentinën. Lajmin e ka dhënë "TyC Sports". Njeriu

që udhëhoqi Argentinën në Kupën e Botës në Katar do ta rinovojë kontratën deri në verën e vitit 2026.

Scaloni ka pasur shumë sukses me Argentinën që kur e mori në vitin 2019. Fillimisht fitoi Kupën e

Amerikës në vitin 2021, më pas trofeun "Finalisima" kundër Italisë dhe në fund trofeun më imponues nga

të gjithë, Kupën e Botës 2022. Zyrtarizimi tashmë është planifikuar për në mars.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare  
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollit 119 date 11.01.2021, divizioni i shitjes dhe qirasë me datën 15.02.2023 bënë shpallje publike për dhënie e pronës së paluajtshme me qira.

### Shpallje Publike

**T-23-05**

Qëllimi i ofertës: Dhënie me qira e një pjese të repartit elektro-puntoria dhe restorantit

Kriteret e Dhënies: Dhënie e kontratës do të bazohet Çmimi më i lartë

Data e shpalljes: 15.02.2023

Sqarimi: deri me 28.02.2023

Kërkesa për pjesëmarrje: Data(t) për kërkesës deri: 28.02.2023

Dorëzimi i ofertave: Behet ne e-Mail: poshtë shënuar ose në zyrën e Divizioni i shitjes dhe qirasë.

Afati i fundit i dorëzimit: Dorëzimi i ofertave bëhet ne formë fizike (zarf te mbyllur) 01.03.2023 në 11:00

Vendi i dorëzimit: Divizioni i shitjes dhe qirasë Trepça Sh.A. Parku Industrial, Mitrovicë

#### AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtarë: <i>Trepça sh.a.</i>		
Adresa postare: <i>Parku industrial</i>		
Qyteti: <i>Mitrovicë</i>	Kodi postarë: <i>40000</i>	Shteti: <i>Kosovë</i>
Kontakti: <i>Burim HAJDINI</i>		Telefoni: <i>+383 (0) 28 538 050</i>
Email: <i>hajdini_b@hotmail.com</i>		Faksi: <i>+383 (0) 28 539 202</i>
<i>www.trepçacorporation.com</i>		

### LAJMËROJMË

Bashkëpronarit LATIF ( RUSTEM ) DESTASNI, RAMIZ ( SADIK ) MUSAJ DHE RESMIJE ( HETEM ) MUSAJ nga Fshat Zojz - Prizren, si Blerësit potencial se, Bashkëpronarët Dragisha Mitrovic, Sasha Mitrovic, Dragan Mitrovic, edhe Rajko Mitrovic, si bashkëpronarë ligjor të ngastrave kadastrale me numër P-71813028-00293, që ka sipërfaqe të përgjithshme prej 20919 m<sup>2</sup>, Zonën Kadastrale Zojz-Prizren, po i Sheshim - pjesët tona bashkëpronësore.

Në këtë mënyrë i ofroj bashkëpronarëve, poqë se janë të interesuar për blerje, të më lajmërohen në afat prej 30 ditëve, në adresë: rr. " Fehmi Lladrovci " nr.70 - Prizren.

Një herri informoj se, e kam Blerësin potencial i cili brenda afatit prej 30 ditëve do ta paguan çmimin e përgjithshëm prej 5.000 €, me para të gatshme-në kesh.

Telefoni kontaktues: +383 (0) 44/351-471

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Sabina Berisha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftat e kl. 10.11.12. të Gjimanzit "Hajdar Dushi".
- Mana Pervorfi Novosell e Ulët, shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f. "Engjull Jak Gjoni" Novosell e Ulët kk Gjakovë nga kl. I-VIII.
- All Star Sport Bar SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit më nr. 811847394.
- Luljeta Qoqaj shpall te pavlefshme deftesat e kl I - VIII shfmu "Lekë Dukagjini" Prizren.
- Ardit Gashi shpall te pavlefshme certifikaten shmlt "11 Marsi" Prizren
- Onda Bilard&Bar SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811348631.
- Jonida Lulzim Haxhiajdini nga Peja shpall të pavlefshme diplomën e fakultetit të edukimit pran universitetit "Fehmi Agani" Gjakovë me nr. 408
- Liki&Abi SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811477589.
- Shahin Arifi shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT : Arkitekt Sinani (Ish Boris Kidric).
- Blerta Gjeloshi shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore " Migjeni"
- Lutfi Hajra shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT " Arkitekt Sinani" ( ish Boris Kidric).
- Xhevdet Brahimi shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Jusuf Rexha".
- Mentor Bunjkau B.I shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb:81036429.
- Famous Club sh.p.k shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 810110114.
- Arbnor Rexhepi shpalle te pavlefshme dëftesat diplomën dhe certifikatën e maturës te SHMLT " Arkitekt Sinani".
- Berat Bajraktari shpalle te pavlefshme dëftesat e vitit I,II,III,IV dhe diplomën e SHMLT " Arkitekt Sinani".
- Shefki Azemi shpalle te pavlefshme certifikatën e lëshuar nga DTC me numër 366/18 Kursi Hidroinstalim-ujësjellës.
- Rafet Durmishi shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT" Arkitekt Sinani".
- Naser Hasani B.I shpalle te pavlefshme certifikatën e TVSH-se e numër 330043737.
- Mentor Rexhepi shpalle te pavlefshme dëftesat diplomën dhe certifikatën e SHMLM" Dr Xheladin Deda".
- Antigone Beka shpalle te pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës se mesme " Dr. Xheladin Deda".
- Vëllezërit Hysa SH.P.K. Dega Kosove shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 811324409.
- Sh.P.K Broja Market shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 810359209.
- Eskont L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr Unik Identifikues 810140335.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



[www.facebook.com/gjeipuneshpejte](http://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



# ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

## Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales




## PASHTETË PULE

MEKA  
HALAL FOOD

gluten  
free



100% mish pule



cilësi e garantuar

pa konservues